



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 4.6.2024, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e traktatit të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Hatixhe Konomi, Blendi Klosi, Etjen Xhafaj, Klodiana Spahiu, Bardhyl Kollçaku, Lavdrim Krrashi, Etilda Gjonaj, Enslemvera Zake, Kreshnik Çollaku, Bledar Çuçi dhe Vangjel Dule.

Mungojnë:

Shpëtim Idrizi, Tomor Alizoti, Tritan Shehu, Greta Bardeli, Petro Koçi dhe Agron Gjekmarkaj.

Të ftuar:

Megi Fino – zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Shpresa Shahaj – drejtoreshë e Drejtorisë për të Drejtën Ndërkombëtare dhe Traktatet në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Jona Suli – drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).

Arbër Qystri – drejtor i Drejtorisë së Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 4.6.2024 me rend dite diskutimin e dy projektligjeve, atij “Për ratifikimin e traktatit të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës”, për të cilin jemi komision përgjegjës dhe relaton zoti Klosi, dhe atij “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin për zhvillim dhe statusin e Zyrës së Koordinimit të Programeve të TIKA-s në Shqipëri”, për të cilin, gjithashtu, jemi komision përgjegjës dhe relaton kolegja Konomi.

Të ftuar për pikën e parë kemi zonjën Fino, zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe zonjën Shahaj, drejtoreshë e Drejtorisë për të Drejtën Ndërkombëtare dhe Traktatet, ndërsa për pikën e dytë, që do ta diskutojmë më vonë, kemi përfaqësuesit e SASPAC-ut, të cilëve u uroj mirëseardhjen!

Mirë, zëvendësministre, dy fjalë rreth traktatit të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Ukrainës.

Fjala për ju.

Megi Fino – Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë të prezantoj para jush projektligjin “Për ratifikimin e traktatit të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës”, nismë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Kjo projekt marrëveshje e ka pikënisjen te vlerësimi i marrëdhënieve shumë të mira dhe miqësore mes dy vendeve tona, marrëdhënie që kanë kulmuar, në fakt, me vizitën e Presidentit Zelenski në Tiranë në shkurt të këtij viti dhe me bashkorganizimin nga Kryeministri Rama të samitit Ukrainë-Europë Juglindore, ku nënshkrimi i këtij traktati gjatë kësaj vizite konfirmoi më së miri këtë nivel marrëdhëniesh, si dhe mbështetjen e palëkundur të Shqipërisë ndaj Ukrainës.

Shqipëria jo vetëm është rreshtuar me partnerët e saj euro-atlantikë në mbrojtje të integritetit territorial të Ukrainës, por, gjithashtu, ka mbështetur pa rezerva edhe Formulën e Paqes, një plan me 10 pika, si rrugëdalja e vetme e konfliktit.

Nëpërmjet këtij traktati të dyja palët zotohen se do të krijojnë kushte të favorshme në bashkëpunimin ekonomik me interes të ndërsjellë dhe se do të mbështeten te njëra-tjetra në sistemin shumëpalësh ekonomik botëror, do të nxisin investimet dhe do të bashkëpunojnë në fusha thelbësore, si: energjia, bujqësia, telekomunikacioni, minierat, transporti, ndërtimi, përpunimi i ushqimit, industria farmaceutike, mjedisi apo edhe shërbimet profesionale.

Palët zotohen, gjithashtu, t'u japin përparësi shkëmbimeve të ndërsjella kulturore, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë në art dhe kulturë.

Prioritet në traktat i jepet qoftë bashkëpunimit në ruajtjen e forcimit të shtetit të së drejtës, si dhe atij ushtarak, qoftë nxitjes së kontakteve të gjithanshme jo vetëm në nivel qendror institucional, por edhe në nivel vendor dhe individual.

Së fundi, në traktat shprehet gatishmëria për bashkëpunim në kuadër të organizatave ndërkombëtare të tilla, si: OKB-ja, OSBE-ja dhe mekanizmat e tjerë institucionalë, ku të dyja vendet janë anëtare, për zgjidhjen e çështjeve të hapura dhe trajtimin me metoda paqësore të mosmarrëveshjeve, në respekt të plotë të së drejtës ndërkombëtare.

Duke ju falënderuar për organizimin e kësaj seance, do të kërkoja dakordësinë tuaj për miratimin e kësaj nisme ligjore, me qëllim hapjen rrugë të finalizimit të hyrjes në fuqi përmes shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit të këtij traktati miqësie me Ukrainën mike.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zëvendësministre!

Zoti Klosi, fjala për ju.

Blendi Klosi – Faleminderit, e nderuar madamë Kodheli!

Pa dyshim, ashtu siç edhe zëvendësministrja e paraqiti, kjo është një përpjekje e përbashkët ndërmjet dy qeverive tona në një moment shumë të vështirë për popullin dhe qeverinë e Ukrainës, ku Shqipëria ka qenë që në ditën e parë mbështetëse e fortë e luftës së drejtë të popullit të Ukrainës dhe të gjitha përpjekjeve që bën ai komb për t'i dëshmuar të gjithë botës se lufta e drejtë, e mbështetur nga aleatët e mëdhenj, është një luftë e cila kërkon sakrifica,

natyrisht edhe stërmundimin, edhe jetën sublime të shumë banorëve të atij shteti. Por është një luftë e drejtë dhe ne e mbështesim pa kushte.

E tillë ka qenë edhe përpjekja e qeverisë shqiptare për të organizuar në Tiranë samitin në mbështetje të Ukrainës, ku të gjitha vendet e rajonit shprehën qëndrimin e tyre pro kësaj mbështetjeje dhe ku Shqipëria dëshmoi edhe një herë forcën e saj në rajon, në lidhshimin dhe në partneritetin e saj me organizatat që mbështesin kauza të drejta në botë.

Edhe kjo marrëveshje vjen si ratifikim i një politike të përbashkët, përmes një vendimmarrjeje të Këshillit të Ministrave të vitit 2024, për një përpjekje shumëvjeçare të dy shteteve tona për të pasur dakordësi në shumë politika, të cilat zëvendësministria i shprehu me shumë kompetencë.

Ndaj, në detyrën e relatorit, unë i kërkoj komisionit të japim dakordësinë tonë për këtë mbështetje, për të cilën besoj se ka një miratim të plotë jo vetëm të politikës shqiptare, por edhe të gjithë popullit shqiptar në raport me luftën e drejtë të popullit ukrainas dhe natyrisht me mbështetjen ndaj presidentit dhe qeverisë së Ukrainës. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Klosi!

Ka komente? Ka pyetje? Shikoj që për momentin nuk ka të tilla.

Unë thjesht dhe vetëm desha të bëj disa komente lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji.

Në fakt, t'ju them të drejtën, përtej të gjithë situatës së jashtëzakonshme, do të thosha, në të cilën Ukraina gjendet sot, e cila përballet çdo ditë e më tepër me një agresion të paprovokuar dhe të padrejtë, siç është ai i Federatës Ruse ndaj qytetarëve dhe territoreve të Ukrainës, sigurisht kjo e bën këtë traktat miqësie dhe bashkëpunimi të ketë një vlerë të shtuar. Por përtej kësaj gjëje, ndaj së cilës nuk do të doja të shtoja asgjë, sepse edhe ju, edhe zoti Klosi thatë shumëçka që ishte e nevojshme, unë do ta zgjeroja pak temën e diskutimit duke thënë se Ukraina është një vend i madh europian, me një potencial të jashtëzakonshëm ekonomik.

Ajo ka qenë para luftës një ndër hambarët më të mëdhenj të prodhimit jo vetëm të grurit, po edhe të shumë drithërave të tjera;

është një vend me pasuri të jashtëzakonshme natyrore dhe një potencial human, gjithashtu, të jashtëzakonshëm;

është një vend që ka në gjirin e vet, në popullsinë e vet, pavarësisht se në një numër jo domosdoshmërisht të spikatur, banorë, qytetarë ukrainas me prejardhje shqiptare;

është një vend me të cilin duhet punuar në lëmin politik, sepse ajo është një ndër vendet që nuk e njeh Kosovën ende;

është një vend që, për shkak të pozicionit të vet strategjik, pozicionimit të tij gjeografik, traversohet, ku kalohet nga rrugë të rëndësishme transporti komercial, të tregtisë detare, tokësore, të cilat lehtësojnë apo thjeshtësojnë aksesin e vendeve të Lindjes së Largët apo të Lindjes së Mesme në një rajon si Ballkani Perëndimor, pse jo, edhe si Shqipëria.

Pra, ky traktat merr një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për faktin se intensifikimi politik dhe i suportit ushtarak, që ne i japim sot Ukrainës është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me agresionin rus, por edhe sepse Ukraina, si një vend me potencial të madh human dhe jo vetëm, është në interesin e Shqipërisë dhe të rajonit të ketë ose të kemi një marrëdhënie më intensive me një vend si Shqipëria. Kjo ishte njëra gjë.

Gjëja tjetër. Besoj se nga pikëpamja edhe e proceseve integruese, tek të cilat Ukraina shikon dhe ka nevojë për mbështetjen e një vendi si Shqipëria, ka dy momente mirëfilli për t'u pasur parasysh apo për t'u diskutuar, meqenëse na jepet rasti të jemi komisioni përgjegjës dhe të flasim për ratifikimin e këtij traktati.

Ukraina ka shprehur publikisht dëshirën, dhe është shumë e vëmendshme ndaj të gjitha zhvillimeve brenda Aleancës së Atlantikut të Veriut, për t'u anëtarësuar në NATO, çka është një pikë kulminante e politikës së saj të jashtme dhe jo vetëm, për të cilën politika mbarëbotërore, sigurisht gjeopolitika ka një vëmendje të veçantë, por ka edhe një kujdes të shtuar kur flitet për anëtarësimin e saj të plotë. Situata është ende ambigue, sepse nuk mund të ketë vendime ose vendimmarrje në kushtet e një lufte që ekziston brenda territoreve të Ukrainës.

Gjithsesi, kjo gjë duhet parë me vëmendje. Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s dhe ka qëndrimet e veta politike lidhur me këtë gjë, sigurisht ato janë të njëjta me ato të partnerëve dhe aleatëve tanë, sidomos atyre strategjikë, por, nga ana tjetër, Ukraina shikon me shumë vëmendje dhe intensitet edhe proceset integruese në Bashkimin Europian, proces ku ndodhet edhe Shqipëria, një proces që mund të na bashkojë një ditë në anëtarësim përtej të gjitha *background-eve* nga të cilat ne vijmë, qofshin ato për shkak të situatës ambigue në të

cilën ndodhen, qofshin edhe për shkak të detyrave të shtëpisë që vazhdojmë të kryejmë çdo ditë.

Jo më larg se para disa minutash, ne sapo mbyllëm mbledhjen e Komisionit për Çështjet Evropiane, ku raportoi ministrja e Shtetit Dhuka lidhur me proceset integruese dhe bërjen e detyrave të shtëpisë, në të cilat Shqipëria ecën. Ndaj edhe e lidh këtë me faktin që Ukraina tenton të jetë në të njëjtat procese dhe të kalojë nëpër të njëjtat procese, pavarësisht situatës që ka sot, sepse gjykon që është në anën e duhur të historisë dhe integrimi i saj në Bashkimin European dhe në NATO do të jenë dy momente historike që do ta demokratizojnë këtë vend akoma më tepër, si dhe do t'i mundësojnë atij një potencial më të madh në përballjen me sfida të jashtëzakonshme, siç është ajo me të cilën përballlet sot.

Kështu, unë dua ta përgëzoj qeverinë shqiptare, në mënyrë të veçantë Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që sjell në një moment domethënës, siç është ky moment që jetojmë sot, një marrëveshje, një traktat miqësie dhe bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Ukrainës, si një kulmim i të gjithë punës që qeveria shqiptare ka bërë për të mbështetur në mënyrë të spikatur, pavarësisht se në përmasat që na takojnë ne si një vend relativisht i vogël, një vend që ka pasur nevojë për një aleat të mirë siç është Shqipëria, gjë të cilën besoj se kemi ditur ta bëjmë mirë, madje shumë mirë.

Shpresoj që edhe momenti i ratifikimit të këtij traktati është pikërisht një nga momentet kulmore edhe të kësaj marrëdhënieje dypalëshe, kështu që do t'i ftoja kolegët ta miratojmë këtë traktat miqësie dhe bashkëpunimi, me votat e të gjithë të pranishmëve.

Kolegu Çollaku ka diçka për të komentuar. Fjala për ju.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zonja kryetare!

Patjetër, pa asnjë diskutim, mbështetja është e plotë dhe bashkohem me kërkesën tuaj për ta mbështetur dhe votuar një marrëveshje të tillë, dhe jo vetëm të një traktati miqësie, por të çdo lloj nisme që sjell, qeveria shqiptare do të ketë nevojë për t'u ballafaquar në një situatë të tillë sfide dhe sigurie.

Në emër të Shqipërisë, patjetër, mbështetja jonë si opozitë do të jetë gjithnjë pa asnjë rezervë.

Unë kam vetëm një sugjerim sa i përket Ministrisë së Jashtme dhe, sigurisht, e kuptoj që jam larg idesë për ta nxjerrë si kusht, por është një prioritet që do të duhej trajtuar nga

Ministria e Jashtme në raport me Ukrainën, që në kohën e duhur, në momentin e duhur, të flitet edhe për njohjen e pavarësisë së Kosovës.

Ka një proces të tillë, të paktën nga kontaktet me kolegë ukrainas të të gjitha niveleve ka një vullnet, një ide të tillë dhe në një moment të duhur, se nuk mund të pretendohet të ndodhë nesër apo në situatë lufte, por patjetër Shqipëria e ka detyrimin të nxisë edhe njohjen e Kosovës nga Ukraina, sigurisht duke u bazuar në këto procese miqësie.

Edhe diçka tjetër, zonja kryetare, por pa lidhje me këtë gjë.

Për procedurë, nëse mund t'jua them, është një kërkesë që unë jua kam bërë disa herë në këtë sallë, disa herë kam pasur edhe mbështetjen tuaj, por edhe për ta lidhur me situatën globale të konflikteve të sigurisë, patjetër edhe të futjes së rajonit të Ballkanit në këtë rreze rrezikshmërie, në këtë komision mungon prej vitesh një interpelancë me ministrin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht emrit dhe kush ai ka qenë.

Unë mendoj se ky komision, ndër më të rëndësishmit në çdo strukturë parlamentare, po edhe shtetërore, ka nevojën dhe çdo ministër ka detyrimin të flasë, të sqarojë çështje që janë sensitive për zhvillimet, sidomos në një rajon me përfshirje të tilla që jemi ne.

Jua them paraprakisht që nuk hyj te njerëzit që mendojnë se çështjet e sigurisë apo të orientimit strategjik të vendit t'i kthejnë në çështje të politikës së ditës. Pra, në rast se ministri preferon të jetë një seancë me dyer të mbyllura apo konfidenciale, nuk kam asnjë rezervë në këtë gjë, por është e papranueshme, mendoj unë, të jetë viti i tretë dhe këtu mungon një ministër i Jashtëm që të flasë me Komisionin për Politikën e Jashtme për paqartësi, për çështje, për informacion, për transparencë; për çfarëdolloj arsyeje.

Po ju them se nuk kam asnjë synim për ta bërë temë debati të politikës.

E bëjmë edhe me dyer të mbyllura, por është e pamundur të mos kemi një komunikim. Ka tre vjet ky komision me një ministër të Jashtëm.

Në këtë rast, shpresoj që zoti ministër, duke qenë edhe më profesionist, edhe më diplomat, do t'i përgjigjet. Por nuk di, ma thoni, si ta formalizoj, zonja kryetare, këtë kërkesë: mjafton ky deklaram publik, apo duhet të bëjmë një letër me shkrim? Unë jam i gatshëm ta bëj, por mendoj se është jetike që ministri të vijë të flasë me Komisionin për Politikën e Jashtme për çështje që na prekin të gjithëve. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Kolegu Çollaku, faleminderit për rikthimin në vëmendje të kësaj gjëje!

Jo, mjafton ky deklarin publik që bëtë.

Më duhet të jem e singërtë me ju. Në komunikimet që unë kam pasur me ministrin Hasani ai ka kërkuar disa herë dhe ka qenë totalisht i disponueshëm të vijë në komision dhe të flasë për çështje të ditës dhe për çështje kardinale të një rëndësie të veçantë, që edhe ju sapo i cekët, madje në më shumë sesa një rast.

Vjen shpejt dita, sepse ai ka treguar më shumë vullnet seç kemi treguar ne me ardhjen e tij, që e realizojmë këtë gjë. Dhe patjetër që do ta realizojmë brenda qershorit. Pak, por e sigurt.

Kështu që, do të biem dakord sipas agjendës sonë dhe agjendës së ministrit, të caktojmë një ditë. Ndoshta do të ishte mirë ta bënim me dyer të mbyllura, pa të regjistruar, pa akses në publik, për shkak të sensibilitetit të disa informacioneve.

Besoj se do të njoftoheni për datën, ndërkohë që mjafton kjo kërkesë që bëni, sepse gjithçka është e regjistruar dhe transmetohet *online* që kjo të ndodhë.

Faleminderit, edhe një herë, që e risollët në vëmendje këtë gjë!

Mirë. Nëse nuk ka ndonjë koment tjetër, unë mendoj ta kalojmë në votim.

Kush është dakord me ratifikimin e traktatit të miqësisë në parim? Nuk ka kundër, nuk ka abstenim.

E konsideroj të miratuar.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Miratohet.

Neni 2. Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

E konsideroj të miratuar.

Në mënyrë të veçantë, falënderoj kolegun Çollaku!

Faleminderit, zonja zëvendësministre, zonja Shahaj dhe punë të mbarë!

E mbylлим këtu diskutimin e këtij projektligji.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 4.6.2024, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin për zhvillim dhe statusin e Zyrës së Koordinimit të Programeve të TIKA-s në Shqipëri” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Hatixhe Konomi, Blendi Klosi, Etjen Xhafaj, Klodiana Spahiu, Bardhyl Kollçaku, Lavdrim Krrashi, Etilda Gjonaj, Enslemvera Zake, Kreshnik Çollaku, Bledar Çuçi dhe Vangjel Dule.

Mungojnë:

Shpëtim Idrizi, Tomor Alizoti, Tritan Shehu, Greta Bardeli, Petro Koçi dhe Agron Gjekmarkaj.

Të ftuar:

Jona Suli – drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).

Arbër Qystri – drejtor i Drejtorisë së Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC).

Mimi Kodheli – Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për bashkëpunimin për zhvillim dhe statusin e Zyrës së Koordinimit të Programeve të TIKA-s në Shqipëri”, për të cilin jemi komision përgjegjës dhe relaton kolegja Konomi.

Prezentë kemi përfaqësuesit e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), zonjën Suli, drejtoreshë e Përgjithshme, dhe zotin Qystri, drejtor i Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Ndihmës së Huaj, të cilëve u uroj mirëseardhjen!

Zonja Suli, fjala për ju, dy fjalë rreth marrëveshjes.

Jona Suli – E nderuar zonja kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme,

Të nderuar deputetë dhe pjesëmarrës,

Marrëveshja, që paraqesim sot për miratim, përbën një hap të ri në fuqizimin e marrëdhënieve miqësore mes Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë dhe vjen si nevojë e kushteve të reja të bashkëpunimit mes vendeve tona.

Mjafton të përmend dy ngjarje të rëndësishme të 5 vjetëve të fundit, rindërtimin pas tërmetit të 26 nëntorit të vitit 2019 me 522 apartamente të financuara dhe të ndërtuara, si dhe mbështetjen ndaj shërbimeve shëndetësore shqiptare nga qeveria turke në rastin e pandemisë Covid-19. Të dy këta shembuj ilustrojnë faktin që bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Turqisë ka tejkaluar dukshëm atë të vitit 2001, vit nënshkrues i marrëveshjes mes qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të Turqisë, miratuar me ligjin nr. 8879 të datës 15.4.2002.

Historiku i bashkëpunimit nis që prej vitit 1996 me hapjen e Zyrës së Koordinimit në Shqipëri, e cila ka një aktivitet me mbi 580 projekte të zbatuara në pothuajse të gjitha fushat ekonomike dhe sociale të vendit. Mbështetja e qeverisë turke për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare në 28 vjetët e fundit llogaritet të ketë qenë më shumë se 50 milionë dollarë.

Kjo marrëveshje e re, e paraqitur në kuadër të këtij projektligji, do të hedhë një hap të ri në vijimësinë e marrëdhënieve miqësore midis të dyja vendeve, si dhe në forcimin e vullnetit për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe zhvillimin e progresit ekonomik dhe social.

Nëpërmjet këtij dokumenti, ne shtyjme më tej bashkëpunimin dypalësh, planifikimin, hartimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit.

Dokumenti që ju keni për shqyrtim ruan një koherencë të përgjithshme të objektivave të bashkëpunimit. Ai është hartuar në bazë të prioritetëve të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimit European (SKZHIE) për periudhën 2021-2030.

Në marrëveshje janë të integruara, gjithashtu, prioritetet strategjike, sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara.

Kjo marrëveshje kuadër merr në konsideratë fusha të gjera të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Turqisë, duke afirmuar edhe një herë bashkëpunimin e gjerë dypalësh në pjesën më të rëndësishme të fushave ekonomike dhe sociale në shkallë vendi.

Vlen të theksojmë fushat e sektorit bujqësor, duke përfshirë bujqësinë, peshkimin, agroindustrinë, sigurinë ushqimore; fushat e sektorit të mjedisit, me mbrojtjen e mjedisit dhe pyjet; industrinë, me zhvillimin industrial cilësor dhe të mbështetur në parimet e qëndrueshmërisë; shëndetësinë; çështjet sociale për uljen e varfërisë; mbështetjen e grupeve të rrezikuara; arsimin dhe kërkimin shkencor; mbrojtjen e trashëgimisë, nxitjen e turizmit e të tjera.

Në një fazë të dytë ne do të kryejmë një shpërndarje të bashkëpunimit në sektorë dhe nënsektorë, në bazë të nevojave strategjike të identifikuara nga ana jonë.

Procesi i implementimit të programeve të qeverisë së Turqisë, që përfshihet në këtë marrëveshje, do të kryhet nga TIKa ose mbi bazë biletarale, ose në bashkëpunim me donatorë të tjerë, me organizata shumëpalëshe, OJF dhe institucione publike e private.

Mbështetja teknike për palën shqiptare do të jepet në formën e transferimit të eksperiencës, trajnimit të stafit, aktiviteteve konsultuese, sigurimit të pajisjeve, shërbimeve dhe teknologjive të reja, ndërkohë që asistencë financiare do të jepet në formën e granteve për mallra, materiale dhe pajisje të nevojshme për realizimin e projekteve apo shërbimeve të caktuara.

Në nivel praktik, statusi i zyrës përfaqësuese të bashkëpunimit turk në Shqipëri është ai i parashikuar në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike, të vitit 1961. TIKa-s i dakordësohen përjashtimet, privilegjet dhe imunitetet lidhur me mjetet e transportit, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, llogaritë bankare, vizat dhe lejet e qëndrimit për zyrtarët dhe anëtarët e tjerë të familjes. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqim të përbashkët të

palëve në çdo kohë ose të zgjidhet nga secila prej palëve pas njoftimit me shkrim për qëllimin dhe zgjidhjen e marrëveshjes. Përfundimi i marrëveshjes nuk prek aktivitete dhe projekte të cilat janë në zbatim ose janë mbyllur. Për të ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe për përmirësimin e aplikimit të saj, do të ngrihet një grup pune i përbashkët midis TIKA-s dhe SASPAC-ut, i cili do të takohet në mënyrë të rregullt dhe të alternuar në Shqipëri dhe në Turqi një herë në vit.

Miratimi i marrëveshjes kuadër, si një dokument bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis qeverisë shqiptare dhe asaj turke, nuk ka efekte financiare apo shpenzime buxhetore shtesë.

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje përcaktohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, për një periudhë 5-vjecare, e cila do të zgjatet automatikisht në mungesë të njoftimeve të kundërta nëpërmjet kanaleve diplomatike.

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji që paraqesim sot, nga njëra anë, nxit bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe një prej partnereve të saj strategjike siç është Turqia, por, nga ana tjetër, është një hap më tej në historikun e gjatë të bashkëpunimit midis shteteve tona; është një mundësi për të ecur para në arritjen e objektivave tanë strategjike, në zhvillimin ekonomik, social e mjedisor.

Për të gjitha argumentet si më lart, të nderuar deputetë, ju ftoj ta miratoni këtë projektligj.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja drejtore!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegu Krrashi, pritni relacionin e koleges Konomi dhe më pas jeni i lutur të merrni fjalën.

Zonja Konomi, fjala për ju.

Hatixhe Konomi – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Besoj se të gjithë kemi dëgjuar për TIKA-n ose, e thënë ndryshe, Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim, e cila është një agjenci shumë serioze, me një aktivitet shumë të gjerë në Shqipëri. Aktiviteti i saj ka nisur që prej vitit 1992 dhe vepron në 61 vende të botës,

ndër to edhe në Shqipëri, ku ka filluar që në vitin 1996, por aktivitetin më të spikatur e ka pasur pas vitit 2004. Aktualisht mund të themi se TIKA numëron rreth 588 aktivitete, projekte në Republikën e Shqipërisë, në fusha të ndryshme, sikundër i përmendi edhe drejtoresha, në shëndetësi, arsim, çështje sociale, bujqësi, trashëgimi kulturore, turizëm, trajnime për administratën publike e të tjera.

Si deputete e Beratit dua të përmend një shembull të mirë bashkëpunimi mes Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës në Bashkinë e Beratit, patjetër, nëpërmjet Ministrisë së Kulturës, dhe TIKA-s. Me mbështetjen e TIKA-s është bërë restaurimi i tri objekteve shumë të rëndësishme të kultit në Berat, i dy xhamive të mrekullueshme, si Xhamia Mbret dhe Xhamia e Beqarëve, dhe i Teqesë së Helvetive, por edhe rehabilitimi i zonave përreth, duke e kthyer qendrën tonë mesjetare në një atraksion edhe më të spikatur, edhe më të frekuentuar turistik; është një ndër zonat më të frekuentuara të qytetit, dhe kjo falë edhe mbështetjes së jashtëzakonshme që ka dhënë TIKA këto vitet e fundit.

Për t'u kthyer përsëri te marrëveshja, ashtu sikur tha edhe drejtoresha, kjo është një marrëveshje kuadër, pra nuk ka efekte financiare, dhe si koordinator për Shqipërinë do të jetë SASPAC-u (Agjencia Shtetërore e Programit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës), që vepron në emër të qeverisë shqiptare, të Këshillit të Ministrave, dhe kjo agjenci do të ndjekë të gjithë koordinimin e programeve të TIKA-s me institucionet përkatëse, të cilat mund të jenë ministri të ndryshme.

Besoj se edhe më pas do t'i kemi më të detajuara dhe marrëveshjet e tjera që do të vijnë për miratim në Parlament.

Jam e sigurt që kjo marrëveshje do të ketë gjithë aprovimin në Komisionin për Politikën e Jashtme, por edhe për të kaluar të enjten në seancë, sepse ne tashmë e kemi testuar prej vitesh marrëdhënien shumë të mirë me qeverinë turke dhe në veçanti me TIKA-n. Kështu që jam e sigurt që të gjithë kolegët do ta mbështesin, sepse, në fund të fundit, ne këtu jemi për të punuar në interes të qytetarëve dhe mendoj se programet TIKA janë ndër më të mirat dhe u kanë shërbyer realisht qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit koleges Konomi!

Kolegu Krrashi, fjala për ju.

Lavdrim Krrashi – Marr shkas nga fakti që javën e kaluar Komisioni për Çështjet Europiane bëri një vizitë në Turqi dhe pikërisht kjo çështje e marrëveshjes u përmend dhe, në fakt, për mua ishte surprizuese, në sensin pozitiv. Në të gjitha takimet kishin njohuri të thella që kjo marrëveshje vjen në Parlamentin e Shqipërisë këtë javë.

Turqia është një vend mik i Shqipërisë, e cila e ka shpallur partnere strategjike qysh prej vitit 2021 dhe Turqia ka qenë gjithmonë mbështetëse e Shqipërisë.

Kam dy çështje shumë shkurt, që ndoshta nuk kanë lidhje direkt dhe specifike me këtë marrëveshje (unë jam i bindur që ajo do të ketë dakordësinë e të gjithë deputetëve në Parlament, pavarësisht dallimeve që kemi), për të cilat mendoj se mund të ndikojë edhe SASPAC-u sa i takon marrëveshjes që ne kemi me shtetin turk, me Republikën e Turqisë, për trajtimin e të sëmurëve. Është për t'u vlerësuar ndihma që ata kanë dhënë sidomos në këtë fushë qysh prej viteve '90. Ka një marrëveshje me Ministrinë e Mbrojtjes posaçërisht, por edhe me Ministrinë e Shëndetësisë. Një problem që kanë qytetarët shqiptarë, që e marrin këtë ndihmë mjekësore në Turqi, është leja e qëndrimit. Mendoj se duhet të ndërhyhet te marrëveshja që kemi, që lejen e qëndrimit ta marrim që në momentin kur nisen prej këtu, jo t'u nënshtrohen procedurave atje. Bashkë me zotën Çollaku dhe me zonjën Tabaku ishim në Turqi javën që kaloi, siç e thashë, dhe të paktën 5 qytetarë që po marrin trajtim mjekësor atje, më kanë kërkuar që të shikohet kjo dhe të futet në marrëveshje, sepse, që të jemi të sigurtë, gjëja e fundit që i shkon ndër mend një personi që është në shtrat dhe familjarëve të tij është leja e qëndrimit. Ne kemi një marrëveshje sipas së cilës për 90 ditë mund të rrih pa leje qëndrimi, por pas 90 ditësh ka pasur edhe raste kur është kërkuar që këta persona të largohen nga Turqia, sepse e kanë tejkaluar afatin e qëndrimit. Kjo është shumë e përgjithshme, por unë e thashë, sepse sa më shumë ta themi, aq më mirë është.

Unë i shikoj të gjitha fushat dhe janë për t'u përshëndetur të gjitha. Tani, përveç 14 fushave të bashkëpunimit, që janë të identifikuar, do të them edhe perceptimin publik, në të cilin bëj pjesë edhe unë (nëse dikush do ta përjashtojë veten, nuk ka asnjë lloj problemi). Në perceptimin publik marrëveshja ose bashkëpunimi, ndihma e TIKA-s në Shqipërisë hyn te kjo e dhjeta: ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore dhe bashkëpunimi kulturor, që, për ta thënë më drejtpërdrejt, janë restaurime apo ndërtime xhamish, fushë e cila është shumë e rëndësishme dhe e vlerësoj shumë, por edhe këto 13 fushat e tjera janë të rëndësishme, në mos

më të rëndësishmet. Si deputet, por edhe si qytetar i Shqipërisë, nëse do të më pyesje se cila është e para, e dyta apo e drejta nga të katërmbëdhjeta fushat, do ta kisha të vështirë të përgjigjesha, por mendoj që xhamitë e të tjera me radhë të jenë të katërmbëdhjetat mundësisht, këto trembëdhjetë të parat të jenë të tjerat, me një renditje krejt *a la carte*, më kuptoni, se nuk dua të keqkuptohem, se në një komision tjetër u keqkuptuam.

Pyetja ime e drejtpërdrejtë është: çfarë mund të bëni ju si SASPAC për ngritjen e kapaciteteve për projekte zhvillimore, sepse nga ajo që unë shoh në bazë, po i referohem qarkut tim, por ka edhe qarqe të tjera të ngjashme në Shqipëri, kapacitetet për hartimet dhe për aplikimet e projekteve janë të ulëta (unë jam shumë i drejtpërdrejtë dhe nganjëherë kjo më krijon probleme, por është normale), që të bëhen projekte edhe për bujqësinë, edhe për agroturizmin, edhe për ujin dhe higjienën, edhe për zhvillimin rural e të tjera e radhë? Duket sikur, dhe këtë prapë e kam nga përvoja në qarkun tim, po të përmendësh TIKA-n, do të thonë se kërkon ndonjë xhami, ndërkohë që ka edhe 13 fusha të tjera ku mund të aplikohen... Pra, e them këtë duke qenë se SASPAC-u ka eksperiencën e tij dhe talentin, njerëzit të cilët janë në gjendje për të hartuar projekte, se gjëja kryesore që mungon këtu është hartimi i projekteve, se aty ku e kemi, e kemi të shkëlqyer dhe e mira flet vetë. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Krrashi!

Kolegu Çollaku, fjala për ju.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë e mbështes pa asnjë rezervë marrëveshjen, i mbështes konsideratat tua, të cilat i ndajmë në mënyrë të njëjtë, se Turqia është një vend mik i jashtëzakonshëm, një partner strategjik i domosdoshëm dhe jetik për Shqipërinë, por edhe për paqen dhe stabilitetin e rajonit. Kështu që pa asnjë lloj rezerve e mbështes dhe e nxis bashkëpunimin. Patjetër, duhet të jemi falënderues, por edhe nxis që të jemi edhe partnerë, përveçse përfitues të kësaj gjëje. I bashkohem shqetësimit të kolegut tim Krrashi, duke qenë se vijmë dhe nga i njëjti qark dhe njohim të njëjtën problematikë. Në fund të fundit, sado dashamirëse dhe miqësore është një ndihmë e huaj, shpeshherë, në varësi të zhvillimit të zonave, mungon një lloj kanali i përshpejtuar i mundësisë së njerëzve poshtë për të pasur aplikueshmëri apo përfitim nga këto fonde. Kështu që unë do të doja shumë që nga ana e qeverisë, pjesës shqiptare, e cila është më ndërmjetëse, të facilitohen sidomos zona si Veriu apo qarku ynë, ku shpeshherë mungon kjo

lloj... Pra, është ndryshe ta trajtosh në mes të Tiranës dhe është ndryshe ta trajtosh në një zonë të thellë të qarkut të Dibrës apo të Kukësit. Kështu që do të doja që, sidomos për zonat veriore apo aty ku mungon ky akses, të mendohet një lloj facilitimi i aksesit të njerëzve.

Përkundër kësaj, e mbështes totalisht marrëveshjen dhe pozicionimin e Shqipërisë në raport me Turqinë, që e konsideron vend mik, partnere strategjike të jashtëzakonshme dhe shumë të rëndësishme për Ballkanin Perëndimor, por, pse jo, tanimë me sa duket ka një riaktivizim edhe drejt proceseve të integritit evropian dhe duket sikur Turqia po rikthehet me të njëjtën mbështetje. Kështu që e deklaroj votën time pro, absolutisht.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Çollaku!

Unë kam një pyetje dhe një kërkesë, zonjë.

Marrëveshja do të jetë në fuqi për një periudhë 5-vjeçare dhe do të zgjatet automatikisht për një periudhë tjetër 5-vjeçare. Pyetja është: zgjatja automatike bëhet pa miratimin e Parlamentit?

Tjetra: në listën e kërkesave që ky komision ka në raport me institucionin që ju drejtoni, janë një sërë kërkesash për informacion, që datojnë që nga viti që shkoi, të cilat, në dijeninë time dhe të të gjithë kolegëve, nuk kanë ardhur. Unë do t'ju lutesha që të gjitha kërkesat që ne i kemi bërë SASPAC-ut për informacionet që kemi kërkuar, të mund të vijnë brenda muajit qershor, në mënyrë që, nëse kemi diçka për të diskutuar, komentuar apo paraqitur pranë jush kërkesën që ju të riktheheni në këtë komision për të dhënë shpjegimet e nevojshme për informacionet që kemi kërkuar, që janë të shumta, këtë mundësi ta kemi të paktën gjatë muajit korrik, para se ne ta mbyllim këtë sesion. Lista është e gjatë, asnjë nga informacionet që kemi kërkuar nuk ka ardhur në komision dhe, sigurisht, kjo është një tërheqje vërejtjeje që ne si komision jua bëjmë juve. E dimë që jeni shumë të ngarkuar, por nuk ka asnjë justifikim që kjo të mos ndodhë. Shpresoj që kjo të jetë hera e fundit që e bëj këtë koment për institucionin që ju drejtoni. Faleminderit!

Jona Suli – E nderuar zonja kryetare, ju falënderoj për çfarë paraqitët!

Zgjatja automatike bëhet pa miratimin në Parlament, në rast se nuk ka kundërshti nga të dyja palët e qeverive.

Ndërkohë, dëshiroj t'ju kërkoj ndjesë për pjesën që nuk kemi kthyer përgjigje. Unë do të interesohem, ndoshta nuk e kam informacionin. Në dijeninë time, për kërkesat të cilat janë

paraqitur kemi kthyer përgjigje, por do ta verifikoj, patjetër, që të mos futem në detaje, dhe do të keni angazhimin tonë maksimal që t'i merrni përgjigjet brenda qershorit. Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, do të më ndihmonte.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Nëse nuk ka ndonjë koment tjetër, mendoj të kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 1.

Miratohet.

Neni 2.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Miratohet pa vota kundër dhe pa abstenime.

Falënderoj në mënyrë të veçantë kolegun Çollaku për angazhimin dhe për votën për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje!

Ju falënderoj, drejtoreshë!

Faleminderit për prezencën, drejtor!

Shpresoj të rishihemi, me informacionet që kemi kërkuar. Ju uroj punë të mbarë, sepse keni një angazhim serioz në këtë drejtim!

Pasi drejtorët të largohen, kërkoj vetëm një minutë kohë nga ju, sepse kam një kërkesë në lidhje me mbledhjen e komisionit që do të bëhet në vazhdim, për ditën. Faleminderit!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA